

(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

European Education Initiative Sh.p.k.

**Shenimet mbi Pasqyrat Financiare per
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**



(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

European Education Initiative është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (në vijim referuar si "Shoqëria") themeluar më datë 19 qershor 2006 dhe e licencuar nga Ministria e Arsimit më datë 20 shtator 2006 bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 636, datë 20 shtator 2006. Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 22 korrik 2009, Shoqëria, nga "Shkollë e Lartë Universitare" u strukturua ligjërisht në "Universitet" dhe është një institucion arsimor i akredituar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është të përmbyshtë standardet dhe të ndjekë programet e miratuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë pa ndonjë diskriminim politik, fetar, racor dhe gjinor. Institucioni ofron një edukim akademik të një niveli të lartë si një përgjigje ndaj kërkesës së studentëve dhe përgatitjen për një karriere të suksesshme.

Shoqëria mëmë është European Education Initiative Holding Sh.p.k., e cila më 31 dhjetor 2019 dhe më 31 dhjetor 2018 zotëron 100 % të kapitalit aksionar të nënshkruar.

Kapitali i Shoqërisë është 400.000.000 Lek.

Bazuar në eskraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë është Z. Henri Cili. Duke filluar nga data 01 gusht 2019, kjo Shoqëri ka administrator Znj Elona Shehu.

Adresa e Shoqërisë është "Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Njësia Bashkiake Nr.7, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria ka pasur 226 punonjës (2018: 221).

2. Baza e përgatitjes

2.1 Deklaratat e përpunueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK").

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqitur në Lekun shqiptar ("Lek"), rrumbullakosur në mijëshen më të afërt. Leku shqiptar është monedha funksionale dhe e paraqitjes për Shoqërinë.

2.3 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve të pasigurisë dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

2.5 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, e cila supozon se Shoqëria do të vazhdojë aktivitetin e saj operacional në të ardhmen e parashikueshme. Në bazë të planit të miratuar financiar të Shoqërisë në vitet e ardhshme, Shoqëria parashikon të rrisë aktivitetin e saj operacional dhe gjithashtu është parashikuar një rezultat pozitiv në vitin e ardhshëm. Përveç sa më sipër, aksionarët e Shoqërisë janë të angazhuar për të mbështetur financiarisht Shoqërinë në rast se do të jetë e nevojshme.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Këto pasqyrat financiare janë të përgatitura në LEK, që është edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e raportimit. Asetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj janë të matura me koston historike, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet ose humbjet e rezultuara nga këto transaksione njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë për 31 dhjetor 2019 dhe 2018 ka qënë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Euro (EUR)	121.77	123.42

3.2 Njohja e të ardhurave

i. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë nga Shoqëria. Të ardhurat reduktohen për kthimet e vlerësuara të klientit, uljet dhe skontot. Të ardhurat do të njihen kur ka prova për ekzistencën e tyre, zakonisht në formën e mallrave të dhëna ose shërbimeve të kryera ku rreziqet dhe përfitimet e lidhura me to janë transferuar nga shitësi te blerësi; mbledhja e të cilave është e mundshme; kostot e lidhura me to dhe kthimet e mundshme të produkteve dhe shërbimeve mund të maten në mënyrë të besueshme; nuk ka përfshirje të vazhdueshme menaxheriale në produktet dhe shërbimet dhe nëse shuma e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Nëse është e mundshme që zbritjet që do të jepen dhe shuma mund të matet me saktësi, atëherë zbritja njihet si ulje nga të ardhurat nga shitja, gjatë procesit të njohjes së të ardhurave. Koha e transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve varet nga kushte specifike gjatë procesit të shitjes.

ii. Shërbimet

Shoqëria i njeh të ardhura nga shitja e shërbimeve në pasqyrat financiare të fitimit ose humbjes mbi bazën e flukseve monetare hyrese të arketuara sipas skedulit të kësteve në kontratat e nënshkruara me klientet.

3.3 Aktive afatgjata materiale

Zëri i aktiveve afatgjata materiale është e matur me kosto historike duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kosto historike përfshin shpenzimet e lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Shpenzimet shpesh do të kapitalizohen në qoftë se nga përdorimi i tyre do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen dhe nëse shuma e tyre mund të matet me besueshmëri. Të gjitha kostot e tjera të mirëmbajtjes dhe riparimit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në kohën kur ato ndodhin.

(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.3 Aktive afatgjata material (vazhdim)

Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur duke shpërndarë koston e aktiveve afatgjata materiale përgjatë jetës së tyre të dobishme. Amortizimi fillon kur aktivi është në dispozicion për përdorim. Normat e amortizimit janë si më poshtë:

Kategoritë e aktiveve	Metoda	Përqindja / vit
Përmirësime të ambjenteve të marra me qira	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	5%
Pajisje zyre	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	25%
Makina	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%
Pajisje kompjuterike	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	25%
Të tjera	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%

Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktiveve rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Vlera kontabël neto do të ulet deri në vlerën e rikuperueshme nëse ajo tejkalon vlerën e mbetur të aktivit.

3.4 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jo materiale të blera nga Shoqëria të cilat kanë një jetë të dobishme të përcaktuar, janë të praqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kosto shtesë

Kostot shtesë do të kapitalizohen në qoftë se nga përdorimi i tyre do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen. Të gjitha kostot e tjera, përfshirë shpenzime për emrin e mirë dhe markave të prodhuara do të njihen në pasqyrën e të ardhurave, kur ato ndodhin. Shpenzimet lidhur me mirëmbajtjen e softëare-ve kompjuterike njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet duke përdorur amortizimin linear mbi jetën e dobishme të aktivitet jo material që nga data e vënies në përdorim. Kostot e licensës Domain dhe Librarisë Virtuale të njohura si aktiv do të amortizohen mbi vlerësimin e jetës së dobishme. Jeta e dobishme rishikohet dhe rregullohet nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Fitimet dhe humjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një aktivi jo-material maten si diferencë midis të ardhurës neto nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël neto të aktivitet dhe njihen si fitime ose humbje.

3.5 Qira operative

Pagesat e bëra për qiranë operative njihen dhe regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve mbi një bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së qirasë. Skontot e marra nga qiradhënësi do të njihen si pjesë e pagesës totale të qerasë sipas termave të qirasë.

3.6 Inventari

Inventari matet me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet bazuar në metodën FIFO dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes dhe kostove të tjera të ndodhura gjatë sjelljes së inventarit në vendodhjen dhe gjendjen aktuale.

(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.7 Aktivet financiare

Instrumentat financiarë të Shoqërisë gjatë 2019 përbëhen vetëm nga instrumenta financiarë joderivative: investime në tituj, hua dhe të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre dhe të pagueshme të tjera. Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë ose me koston e amortizuar, sipas klasifikimit të tyre.

Njohja

Shoqëria fillimisht njeh të arkëtueshmet financiare, dhe llogaritë e investimeve në datën në të cilën janë krijuar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Matja e mëvonshme

Të gjitha aktivet financiare do të jenë i rivlerësimeve pas njohjes së tyre në kontabilitet, të cilat do të maten me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë. Një matje e tillë është e zbatueshme për të gjitha aktivet dhe/ose detyrimet financiare. Në mënyrë të veçantë, për investimet e borxhit që i përkasin një modeli biznesi, objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale të përbëra nga pagesa për principalin dhe interesin janë përgjithësisht të matura me koston e amortizuar në fund të periudhave raportuese. Instrumentat e borxhit që i përkasin një modeli biznesi objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare dhe shitja e aktiveve financiare, janë të matur në përgjithësi në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në arkë dhe llogari rrjedhëse të mbajtura me kosto. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Investime në tituj

Investimi në tituj njihet me shumën e mjeteve monetare të paguara për të blerë aksionet. Humbja nga zhvlerësimi është diferenca mes vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të vlerësuara monetare të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbje nga rënia në vlerë. Llogaritë e arkëtueshme aftashkurtra nuk skontohen.

Huatë dhe llogari të pagueshme të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera njihen me vlerën e tyre të amortizuar.

(i) Njohja e zhvlerësimit të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ekziston një tregues objektivi që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur një ndikim negativ në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivit financiar.

Një zhvlerësim në vlerë në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferenca mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të aktivit. Aktivet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim mbi bazë individuale. Aktivet e mbetura financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njohur. Rimarrja njihet në pasqyrën e performancës.

(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.7 Aktivet financiare (vazhdim)

Huatë dhe llogari të pagueshme të tjera (vazhdim)

(ii) Çregjistrimi

Aktivët financiarë çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur transferon aktivin financiar në një transaksion në të cilën kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar transferohen. Një detyrim financiar çregjistrohen kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ose janë anulua

(iii) Kompensimi i instrumentave financiarë

Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen në shumën neto që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur, Shoqëria ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe nuk synon të vendosë mbi shlyerjen mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

(iv) Vlera e drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka çmime tregu të dukshme, kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit si më poshtë:

- **Niveli 1:** Çmimet e tregut të kuotuar (të parregulluara) në treg aktiv për instrumenta identike;
- **Niveli 2:** Teknika vlerësimi të bazuara në të dhënat të vëzhgueshme, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë (për shembull çmimi) ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë (për shembull të përftuara nga çmimi). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuar në tregje aktive për instrumenta të njëjtë; çmimet e kuotuar për instrumenta identik ose të njëjtë në treg që konsiderohen më pak aktive; ose teknika vlerësimi ku të gjithë të dhënat hyrëse janë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.
- **Niveli 3:** Teknika vlerësimi duke përdorur të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku metoda e vlerësimit përfshin të dhëna hyrëse të cilat nuk janë të bazuara në të dhëna hyrëse të vëzhgueshme dhe ato kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta të cilat janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumenta të njëjtë ku rregullime të pavëzhguara të rëndësishme ose supozime janë të detyruara që të reflektojnë diferencat midis instrumentave.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të flukseve monetare, krahasime me instrumenta të njëjtë për të cilat ekzistojnë çmime të vëzhgueshme në treg dhe të bazuara në kurbën e kthimit aktual të përshtatshme për pjesën e mbetur të maturitetit.

Supozimet dhe të dhënat hyrëse në metodat e vlerësimit përfshijnë norma interesi pa risk, hendekun e kredisë dhe prime të tjera të përdorura në llogaritjen normave të skontuara, obligacionet dhe çmimi i kapitalit neto, kurset e këmbimit, çmimi i kapitalit neto dhe çmimi i indeksuar i kapitalit neto dhe luhatjet korrelacionet e pritshme. Objektivi i teknikave të vlerësimit është që të arrijë në përcaktimin e vlerës së drejtë, e cila reflekton çmimet e instrumentave financiarë në datën e raportimit, që mund të ishte përcaktuar nga pjesëmarrësit në treg që veprojnë në mënyrë të vullnetshme.

(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.7 Aktivet financiare (vazhdim)

Huatë dhe llogari të pagueshme të tjera (vazhdim)

(iv) Vlera e drejtë (vazhdim)

Shoqëria përdor modele vlerësimi të njohura për përcaktimin e vlerës së drejtë për instrumenta financiare të zakonshme dhe të thjeshta si normat e interesit dhe monedha të shkëmbyeshme sëap, të cilat përdorin të dhëna tregu të vëzhgueshme dhe kërkojnë pak gjykim dhe vlerësim nga drejtimi.

Çmimet e vëzhgueshme dhe të dhënat hyrëse në modele janë zakonisht të disponueshme në tregjet për borxhet dhe letrat me vlerë të kapitalit të listuar, shkëmbim derivativësh të tregtueshme dhe derivativë të thjeshtë si p.sh. normat e interesit sëap. Disponimi i çmimeve të vëzhgueshme në treg dhe të dhënave hyrëse në modele ul nevojën për vlerësimin dhe gjykimin e drejtimit dhe gjithashtu ul pasigurinë që lidhet me përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponimi i çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe të dhënave hyrëse në modele ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është i prirur që të ndryshojë në bazë të ngjarjeve specifike dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozitat bankare dhe fitimet nga transaksionet në monedhë të huaj. Të ardhurat nga interesi njihen kur ato konstatohen.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet financiare nga huamarrjet, humbjet në monedhë të huaj dhe ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare përmes fitimit apo humbjes në vlerë të drejtë (nëse ka). Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e performancës financiare kur ato ndodhin.

3.9 Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurta të punonjësve janë llogaritur mbi një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime kur shërbimi është kryer. Një detyrim njihet për shumën që pritet të paguhet nga përfitimet afatshkurta, nëse Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të ofruara nga punonjësit dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

3.10 Përfitimet e punonjësve

Në përputhje me kushtet e Kodit të Punës, kompanitë shqiptare janë të detyruara të paguajnë kontribute mujore për përfitime të daljes në pension të parashikuara për punonjësit e tyre të administruara nga skema me kontribute të përcaktuara të shtetit. Shoqëria nuk ka detyrime shtesë për punonjësit që largohen nga kompani apo të drejtën për kontributet pensionale.

3.11 Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi mbi të ardhurat i parapaguar

Aktivitet dhe detyrimet e të ardhurave të parapaguara për periudhën aktuale dhe të mëparshme maten me shumën që pritet të rikthehet ose të paguhet në organet tatimore. Normat tatimore dhe ligjet tatimore nga ku shuma e tatimit janë llogaritur janë ato që janë miratuar në datën e raportimit.

(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.11 Tatimi mbi të ardhurat (vazhdim)

Tatimi mbi të ardhurat e shtyra

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, sipas ligjeve në fuqi. Një aktiv ose detyrim tatimor i shtyrë njihet nëse ekziston një e drejtë ligjore për kompensim në lidhje me tatimin mbi të ardhurat e parapaguara të mbledhura nga i njëjti autoritet.

3.12 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të kaluara, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet me besueshmëri dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parash dhe rreziqeve specifike të detyrimit. Tarifat për ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme, qoftë pjesë e tarifës fillestare ose një tarife të veçantë, njihen si të ardhura kur shërbimet ofrohen. Kur tarifa e veçantë nuk mbulon koston e shërbimeve të vazhdueshme së bashku me një fitim të arsyeshëm, një pjesë e tarifës fillestare, e mjaftueshme për të mbuluar kostot e shërbimeve të vazhdueshme dhe për të siguruar një fitim të arsyeshëm për këto shërbime, shtyhet dhe njihet si e ardhur nga shërbimet e dhëna.

EUROPEAN EDUCATION INITIATIVE SH.P.K.
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

4. Aktive afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale për 31 dhjetor 2019 janë të përbëra si më poshtë:

Kosto	Toka	Makineri e pajisje dhe instalime teknike	Mjete transporti	Përmirësime të ambienteve të marra me qira	Mobilje dhe pajisje	Pajisje kompjuterike	Totali
Gjendje më 31 dhjetor 2017							
Shtesa							
Transferime							
Pakësime							
Gjendje më 31 dhjetor 2018	1,255,250,259	44,232,486	5,867,946	153,949,176	70,137,146	80,391,709	1,609,828,722
Shtesa		160,000		1,747,795	6,597,684	7,629,932	16,135,411
Transferime							-
Pakësime			3,091,060				3,091,060
Gjendje më 31 dhjetor 2019	1,255,250,259	44,392,486	2,776,886	155,696,971	76,734,830	88,021,641	1,622,873,073
Zhvlerësimi i akumuluar							
Gjendje më 31 dhjetor 2017							
Zhvlerësimi i vitit							
Pakësime							
Gjendje më 31 dhjetor 2018	-	35,087,190	3,858,338	69,686,129	50,331,337	55,088,745	214,051,739
Zhvlerësimi i vitit		1,831,725	1,779,325	4,235,315	5,091,144	7,359,185	20,296,694
Pakësime			3,091,060				3,091,060.00
Gjendje më 31 dhjetor 2019	-	36,918,915	2,546,603	73,921,444	55,422,481	62,447,930	231,257,373
Vlera e mbetur neto	1,255,250,259	7,473,571	230,283	81,775,527	21,312,349	25,573,711	1,391,615,700
Gjendje më 31 dhjetor 2017							
Gjendje më 31 dhjetor 2018	1,255,250,259	9,145,296	2,009,608	84,263,047	19,805,809	25,302,964	1,395,776,983
Gjendje më 31 dhjetor 2019	1,255,250,259	7,473,571	230,283	81,775,527	21,312,349	25,573,711	1,391,615,700

5. Aktive afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

Kosto	Aktivët AGJ jomateriale	
Gjendje më 31 dhjetor 2017		
Shtesa		
Gjendje më 31 dhjetor 2018	65,374,291	
Shtesa	1,220,868	
Gjendje më 31 dhjetor 2019	66,595,159	
Zhvlerësimi i akumuluar		
Gjendje më 31 dhjetor 2017		
Zhvlerësimi i vitit		
Gjendje më 31 dhjetor 2018	55,045,324	
Zhvlerësimi i vitit	9,261,905	
Gjendje më 31 dhjetor 2019	64,307,229	
Vlera e mbetur neto	2,287,930	
Gjendje më 31 dhjetor 2017		
Gjendje më 31 dhjetor 2018	10,328,967	
Gjendje më 31 dhjetor 2019	2,287,930	

Kosto	Aktivet AGJ jomateriale		Totali
Gjendje më 31 dhjetor 2017			
Shtesa			
Gjendje më 31 dhjetor 2018	65,374,291		65,374,291
Shtesa	1,220,868		1,220,868
Gjendje më 31 dhjetor 2019	66,595,159		66,595,159
Zhvlerësimi i akumuluar			
Gjendje më 31 dhjetor 2017			
Zhvlerësimi i vitit			
Gjendje më 31 dhjetor 2018	55,045,324		55,045,324
Zhvlerësimi i vitit	9,261,905		9,261,905
Gjendje më 31 dhjetor 2019	64,307,229		64,307,229
Vlera e mbetur neto	2,287,930		2,287,930
Gjendje më 31 dhjetor 2017			
Gjendje më 31 dhjetor 2018	10,328,967		10,328,967
Gjendje më 31 dhjetor 2019	2,287,930		2,287,930

Më 31 dhjetor 2019, aktivet jo materiale të Shoqërisë nuk janë përdorur si kolateral për hua të marra ndaj institucioneve të kredisë ose të tjera.

6. Aktive financiare

Aktivet financiare të Shoqërisë në 31.12.2018 në vlerën 1.102.905.286 leke, përfaqësojnë 95.35 % të kapitalit të shoqërisë Klinika Shqiptare sh.a, sipas kontratës me 26.12.2017 të transferimit të pronësive të aksioneve në favor të EEI shpk.

Më 31 dhjetor të viti 2019 Klinika Shqiptare Sh.a na ve në dijeni përmes shkresës, mbi zhvlerësimin dhe shitjen e aktiveve të paluajtshme ndertese+truall në vlerën 670.207.029 leke. (670.207.029 *95.35%).

Si pasojë e ngjarjes së ndodhur vlera e aktiveve financiare më 31.12.2019 është 463.862.884 leke.

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit	463,862,884	1,102,905,286
Totali	463,862,884	1,102,905,286

7. Inventari

Inventari i imet më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 perbehet nga :

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Inventari	3,567,005	4,812,697
Totali	3,567,005	4,812,697

8. Të drejta të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	307,830,909	265,606,262
Nga njësitë ekonomike brenda grupit	44,082,631	41,693,582
Të tjera	47,270,570	21,166,792
Zhvlerësimi i akumuluar më 31 dhjetor 2019		
Humbje nga zhvlerësimi të vitit		
Totali	399,184,110	328.466.636

Llogaritë e arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit janë balancat e klienteve (te studenteve) të cilat nuk janë arkëtuar. Ndërsa për sa i përket njësive ekonomike brenda grupit janë kryesisht shërbime që i janë ofruar shoqërive partnere për ambientet me qira, parkim etj. Tek zeri të tjera janë shërbime ofruar shoqërive të tjera si edhe shpenzimet që janë kryer nga kompania por që i perkasin periudhave të ardhshme.

9. Shpenzime të shtyra

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Shpenzime të shtyra	98,112,190	135,868,972
Totali	98,112,190	135,868,972

Shpenzimet e shtyra janë kryesisht pagesa në avance ndaj furnitorëve për shërbime dhe ambientet me qira ku zhvillojnë aktivitetin si edhe parapagimet ndaj personelit të shoqërisë.

10. Mjete monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Paraja në arkë	496,668	27,062
Lek		



11
me Z. K.

Paraja në bankë

Lek	13,257,527	39,232,483
-----	------------	------------

Totali

13,754,194

39,259,545



[Handwritten signature]

11. Kapitali aksionar dhe rezerva ligjore

Tabela më poshtë tregon strukturën e kapitalit të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018:

Aksionarët	Vlera e kuotave 2019	Aksione në %	Vlera e kuotave 2018	Aksione në %
European Education Initiative Holding Sh.p.k.	429,414,042	100%	267.329.096	
Totali				

12. Detyrime ndaj institucioneve të kredisë

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Pjesa e huave afatgjata	14,240,280	23,492,730
Totali hua afatgjata		
Pjesa e huave afatshkurtra	14,979,863	14,474,186
Totali hua afatshkurtra		
Totali	29,220,143	37,966,916

Ne 31.12.2019 pjesa e huave afatgjata perfaqeson detyrimin mbi nje vit per kredine e marre prane Bankes ABI dhe Fondit Besa. Pjesa e huave afatshkurtra perfaqeson detyrimin deri ne 1-vit prane ketyre insitucioneve .

13. Detyrime ndaj njësitë ekonomike brenda grupit

Hua të marra nga njësitë ekonomike brenda grupit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Pjesa e huave afatgjata	1,573,538,275	1,637,253,198
Totali hua afatgjata		
Pjesa e huave afatshkurtra	61,167,506	58,999,957
Totali hua afatshkurtra		
Totali	1,634,705,781	1,696,253,156

Pjesa e huave afatgjata perfaqeson kryesisht detyrimin ndaj EEI holding sipas kontrates se huase si edhe detyrimet ndaj shoqerise partnere Klinka Shqipatare sh.a per ambjentet me qera ku zhvillojme aktivitetin. Pjesa e huave afatshkurtra perfaqeson kestet e huase principal sipas skedulit te percaktuar ne kontraten e huase qe do te paguhet deri ne 1-vit.

14. Të pagueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të pagueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Të pagueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit	90,332,541	87,578,034
Të pagueshme ndaj personelit	61,660,391	46,522,648
Kontribute shoqërore dhe shëndetësore	7,312,782	4,819,590
Tatimi mbi të ardhurat personale	5,066,639	2,641,599
Tatim në burim	470,522	781,712
Tatime të tjera të pagueshme	76,731,551	63,603,722
Detyrime të tjera	21,272,874	6,050,470
Totali	262,847,301	211,997,776

Të pagueshme nga aktiviteti i shërbimit janë kryesisht detyrimet ndaj furnitoreve për mallra e shërbime, detyrimet ndaj personelit për paga e shpërblime, detyrimet tatimore si edhe detyrimet ndaj treteve.

14. Të ardhura të shtyra

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Të ardhura të shtyra afatgjatë	103,082,053	117.528.829
Të ardhura të shtyra afatshkurtër	441,899,229	476.028.307
Totali	544,981,282	593.557.136

Të ardhurat e shtyra afatgjata janë të ardhura që i perkasin viteve në vazhdim (2021 e më tej). Ndërsa të ardhurat e shtyra afatshkurtra i perkasin të ardhurave të vitit 2020 në bazë të kontratave të nënshkruara nga palet.

15. Analiza dhe rakordimi i shitjeve

A		
Shuma e shitjeve të raportuara me FDP		681,703,338
Nga kjo		
B	Deklaruar në pasqyra financiare	721,675,053
	Të ardhura të periudhave të ardhshme afatshkurtra (zeri bilanc 14)	441,899,229
	Të ardhura të periudhave të ardhshme afatgjata (zeri bilanc 14)	6,672,461
	Të ardhura të rimarre nga Studente që i perkasin vitit aktual (zeri bilancit 14 viti 2018)	(476,028,307)
	Të ardhura të rimarre nga Studente që i perkasin viteve të ardhshme (zeri bilancit 14 viti 2018)	(17,725,765)
	Diferenca kursi kembimi dhe sistemime	5,210,667
	Totali	681,703,338
	Diferenca A-B	

16. Të ardhura nga shërbimet

Të ardhurat më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga tarifat e shkollimit:	663,300,718	826.521.616
Bachlor		
Master		
Doktoraturë		
Totali	663,300,718	826.521.616

Të ardhurat nga shërbimet përbëhen nga tarifat e arsimit të përcaktuara me këstin e paracaktuar sipas kontratës me klientët për vitin përkatës shkollor. Të ardhurat nga shërbimet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 përbëhen nga të ardhurat që i përkasin vitit akademik 2018-2019(janar-qershor 2019) dhe 2019-2020(tetor-dhjetor 2019).

17. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Te ardhura nga parkimi		1,280,100
Te ardhura nga shërbime	12,734,538	7,771,671
Te ardhura nga qera	9,130,943	10,610,945
Te ardhura nga grantet	36,198,214	22,474,090
Te ndryshme	640	5,989
Te ardh.nga shitja AQ	310,000	
Totali	58,374,334	42,142,779

Te ardhura të tjera janë të ardhura që i përkasin shërbimeve të tjera që ofron kompania jone si parkim ,qera vertetime ,projekte etj

18. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbëhen nga paga dhe kontributet të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime page	- 270,152,090	-266,826,191
Shpenzime për kontributet shoqërore dhe shëndetësore	- 31,729,721	-29,987,758
Totali	-301,881,811	-296,813,949

19. Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare

Humbjet nga zhvleresimi më 31 dhjetor 2019 janë sipas njoftimit mbi zhvleresimin dhe shitjen e aktiveve të paluajtshme ndertese + truall të Klinika Shqiptare sh.a. në vlerën 639.042.240 leke :
(670.207.026 leke * 95.35 % të aksioneve të zotëruara nga EEI shpk)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Zhvleresim i aktiveve dhe investimeve financiare	-639,042,240	0
Totali	-639,042,240	0

20. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet administrative më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime mirmbajtje	14,596,408	15,032,205
shpenzime qeraje	77,688,360	80,083,401
Shërbime sigurie	6,861,325	6,497,273
Ujë dhe energji elektrike	12,966,435	12,491,31
Shërbime konsulence	10,658,142	7,013,519
Naftë për gjeneratorë dhe pajisje ngrohëse	1,454,776	1,723,083
Kancelari dhe materiale	9,640,473	10,553,36
Shpenzime lidhur me mjetet e transportit	34,612	36,296
Tarifa	4,191,961	9,835,832
Shpenzime përmbarimi	9,597,579	2,791,422
Trajnime dhe shpenzime të tjera personeli	38,072,062	36,135,330
Shpenzime përfaqësimi	3,190,259	3,648,911
Subvencione të dhena	10,431,226	16,730,702
Publicitet, reklama	6,889,232	28,487,740
Shpenzime të ndryshme	2,014,252	4,535,561
Shërbime bankare	2,464,794	2,688,744
Totali	210,751,896	238,284,695

Shpenzimet administrative janë të gjithë shpenzimet korente të kryera nga kompania për zhvillimin e aktivitetit të saj gjatë vitit financiar.

22. Shpenzime interesi

Shpenzimet e interesit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 201
Shpenzime interesi	- 70,023,268	- 96,247,662
Totali	- 70,023,268	-96.247.662

Shpenzimet e interesit janë shpenzime të kryera për huatë të marra nga kompania nga njesite ekonomike brenda grupit si edhe ndaj institucioneve të kredise .

23. Fitimi/(humbja) nga kursi i këmbimit, neto

Fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitimi nga kursi i këmbimit	24,369,549	149.320.273
Totali	24,369,549	149.320.273

24. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	- 31,312,189	-29,060,249
Totali	- 31,312,189	-29,060,249



25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhet nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzim për tatim fitimin	-21,817,570	- 54,341.944
Totali	-21,817,570	- 54,341.944

Tatimi mbi të ardhurat përbëhet nga tatimi mbi të ardhurat për vitin financiar 2019. Në përputhje me rregulloren tatimore Shqiptare, norma e aplikueshme e tatimit për vitin 2019 është 15%

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	-506,966,965	357.578.11
Shpenzime të pazbritshme :		
Shpenzime të tjera të pazbritshme	652.417.433	4,701,514
Pritje percjellje	1,136,444	1,043,918
Te ndryshme penalitet	9,434,736	1,323,179
Shpenzime pa fature tatimore	2,803,851	2,334,417
Zhvleresim i aktiveve financiare	639.042.402	
Totali i shpenzimeve të pazbritshme	652,417,433	4,701.514
Fitimi i tatueshem	145,450,468	362.279.627
Shpenzimi tatimor i vitit	21,817,570	54.341.944
Përqindja efektive e tatim mbi fitimin	15%	15%

Kthimet tatimore paraqiten çdo vit, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar për qëllime tatimore mbetet e përkohshme deri sa autoritetet tatimore të shqyrtojnë raportet dhe të dhënat e tatimpaguesit dhe të bëjnë një vlerësim përfundimtar. Ligjet tatimore shqiptare dhe rregulloret janë subjekt i interpretimeve nga organet tatimore.